

Testet e aftësisë

«Shpesh e ndiej si njëfarë racizmi të fshehur. Shumë njerëz mendojnë, ky nuk e di mirë gjuhën ose flet çuditshëm dhe mendojnë automatikisht se ky nuk di të mendojë.» **Rachad Kanawati, Siri**

«Gjuhën duhet ta zotërosh patjetër. Asgjë tjetër nuk ndihmon. Asgjë nuk të falet. Por edhe këtë mund ta mësosh. Duke lexuar shumë dhe duke folur me njerëz të tjerë.»

Preethy Vaddakkadath, Indi

Gjuhët – çelësi për testet e aftësisë

Testet e aftësisë janë të njëjta për të gjithë. Pa marrë parasysh a keni vijuar shkollën në Zvicër ose jetoni këtu vetëm 2 – 3 vjet.

Testi i aftësisë kërkon që ju të zotëroni gjuhën mirë. Dhe ju duhet të keni njohuri të mira të gjuhës për secilën lëndë, sepse duhet t'i kuptoni detyrat para se të mund t'i zgjidhni ato.

Për shembull:

Ekuacione me tri të panjohura

2 kopshtarë dhe 1 kopshtare punojnë 4 ditë për të prashitur një copë toke. Sa do të zgjaste prashitja nëse dyfishohet numri i punëtorëve profesionalë të cilët e prashitin tokën?

Rezultati: 2 ditë


Llogaritë themelore

Sonja dhe Larissa krahasojnë kontot e tyre bankare. Gjendja e kontos së Sonjës është 1'394 franga më pak se ajo e Larisës. Larisa ka 9341 franga në konto. Sa para ka Larissa në konton e saj bankare?

Rezultati: 7'947 franga

Llogaritje themelore dhe logjika

Ju jeni duke udhëtuar me tren nga A (pika e kuqe) në B (pika e kaltër). Secila pjesë e rrugës mes stacioneve -prej një pike deri te tjetra –kushton 1 frang e 80. Cilën rrugë e zgjidhni dhe sa kushton bileta juaj?



Rezultati: Rruga më e shpejtë shpie mbi dy pjesë të rrugës. Bileta kushton 3 franga e 60.

Kombinimi i numrave

Nënvizoni të gjithë ata numra, te të cilët shifra e parë është tek dhe shifra e dytë çift.

32 23 44 51 62 74 80 15 92 14 27 18

Rezultati: 32 23 44 51 62 74 80 15 92 14 27 18

Më shumë detyra gjeni nën www.sixpack-comic.ch/testncheck.

Gjuhët

Ju duhet të kuptoni gjuhën, për të qenë në gjendje për t'i zgjidhur detyrat. Më vështirë është te detyrat gjuhësore. Këtu nuk vlerësohet vetëm sa e njihni gjuhën, por edhe si mund ta përdorni atë.

Lakim dhe zgjedhim

Vendosni shprehjet ose shtesat gjegjëse në secilin zbraztësirë.

Nëse doni të konkurroni për një vend për mësimin e profesionit, atëherë keni nevojë për një dosje të kompletuar të aplikacionit. Në këtë dosje duhet bashkëngjitur letrën e motivimit për aplikacion, biografia në formë tabelore, certifikatat e tri vjetve të shkollës, raporte të praktikave provuese dhe rezultatet e testit të aftësisë. Shumica e ndërmarrjeve për mësim të profesionit vendosin pas një shikimi të parë nëse është e kompletuar dosja e aplikimit me të gjitha dokumentet. Nëse mungojnë dokumente me rëndësi, atëherë përgjegjësi e kthen dosjen me refuzim ose - nëse janë të mirë - ju lusin t'i dërgoni dokumentet, të cilat mungojnë.

Nëse doni të konkurroni për një vend për mësimin e profesionit, atëherë keni nevojë për një dosje të kompletuar të aplikacionit. Në këtë dosje duhet bashkëngjitur letrën e motivit për aplikacion, biografia tabelore, certifikatat e tri viteve të shkollës, raporte të praktikave provuese dhe rezultatet e testit të aftësisë. Shumica e ndërmarrjeve për mësim të profesionit vendosin gjatë një shikimi të parë nëse është e kompletuar dosja e aplikacionit me të gjitha dokumentet. Nëse mungojnë dokumente me rëndësi, atëherë përgjegjësi e kthen dosjen me refuzim mbrapa ose - nëse janë të mirë - ju lusin t'i dërgoni prapë dokumentet, të cilat mungojnë.

Ndërtimi i fjalisë

Krijo fjali të plota, të cilat përmbajnë të gjitha fjalët gjegjëse.

Shpejtë- dosjen e aplikimit -na- mungojnë - lutemi - dokumentet - në - ju - të - mundësisht - dërgoni- ato - tuaj-sa-më

Ju lutemi, që mundësisht sa më parë, të na dërgoni dokumentet, të cilat mungojnë në dosjen tuaj të aplikimit.

Viteve- të- fundit- të- shkollës - mungojnë - çfarë - tri - vallë- duhet - fundit - mua- më- certifikatat?

Çfarë të bëj vallë? Mua më mungojnë certifikatat e tri viteve të fundit të shkollës.

keni -pse - kryer - Sqaroni - praktikë provuese - nuk - keni - lart motivimit- aplikim - asnjë - ende!

Sqaroni në letrën e laartmotivimit për aplikim, pse nuk keni kryer ende asnjë praktikë provuese!

Cilat fjalë nuk përshtaten në radhë?

1	vrapim	ecje	fluturim	shëtitje	marshim
2	Ahu	Trëndafili	Verri	Lisi	Bredhi
3	I pafuqi	i sjellshëm	i mirë	i dashur	shumë i këndshëm
1	vrapim	ecje	fluturim	shëtitje	marshim
2	Ahu	Trëndafili	Verri	Lisi	Bredhi
3	I pafuqi	i sjellshëm	i mirë	i dashur	shumë i këndshëm

Kuptim i tekstit

Marjami është e pasigurtë. Me shpresa të mëdha e ka dërguar para disa ditësh dosjen e saj të aplikimit. Vendi për mësimin e profesionit do të ishte ajo që ëndërronte. Ajo gjithashtu e di se do të ishte shumë e përshtatshme për këtë profesion. Dhe ajo ka treguar shumë zell, ka hulumtuar gjatë, dhe ka zbuluar shumë mbi ndërmarrjen. Ajo i ka skanuar të gjitha dokumentet e saj dhe të gjithë pakon ia ka dërguar ndërmarrjes përmes postës elektronike. Dhe tash kjo! Vetëm një email i shkurtër si përgjigje: «Ne kemi pranuar shumë aplikacione dhe për këtë arsye ju lutemi të keni pak durim.»

- Marjami ka marrë përgjigje negative.
- Marjami ka shumë konkurrenca dhe konkurrentë.
- Marjami e ka siguruar vendin për mësimin e profesionit.
- Marjami ka harruar të dërgoj biografinë tabelore
- Marjami ka shumë konkurrenca dhe konkurrentë.

Shkrimi i tekstit

Dosjen tuaj të aplikimit duhet dërguar nëpërmjet internetit. Shkruani edhe email-in përcjellës.

Dy zgjidhje të mundshme si mund të shkruani këtë email :

- Shumë e nderuara zonja Kuhn
Ju falënderoj që gjetët kohë për mua, për të biseduar në telefon. Me kënaqësi ju dërgoj dokumentacionin tim të aplikimit.
Do të gëzohem të dëgjoj prej jush
Përshëndetje miqësore
xxx
- Të nderuara zonja, të nderuar zotërinj
Vendin e lirë për mësimin e profesionit në ndërmarrjen tuaj e kam pa në www.berufsberatung.ch dhe ju dërgoj me kënaqësi dosjen time të aplikimit. Do të më gëzonte shumë, nëse ju do të shprehnit dëshirën për të më njohur personalisht, duke më ftuar për një intervistë për aplikim.
Përshëndetje miqësore
xxx

Zgjidhja e sipërme është më kuptimplotë.

Pasurie e fjalorit

Shikoni çiftet e fjalëve më poshtë .

- a) Cilat prej dy fjalëve kanë kuptime të ngjashme? → a
 b) Cilat prej dy fjalëve kanë kuptime të kundërta? → b
 c) Cilat prej dy fjalëve kanë kuptime të ndryshme? → c

- e përditshme e zakonshme
 guximi frika
 Laureshë larsh
 serioz qesharak
 i fuqishëm llafazan
 ngutet vrapon

- a e përditshme e zakonshme
 b guximi frika
 c Laureshë larsh
 b serioz qesharak
 c i fuqishëm llafazan
 a ngutet vrapon

Cila shprehje duhet vendosur në rreshtin e djathtë, që çifti i fjalëve në të djathtë të krijojë një analogji me çiftin e fjalëve në anën e majtë?

këmbë	çorapë	qafë	_____
bukë	bukëpjekës	mish	_____
tërshërë	kalë	benzinë	_____
biçikletë	zile	makina e policisë	_____
banane	frutë	karotë	_____

këmbë	çorapë	qafë	shall
bukë	bukëpjekës	mish	kasap
tërshërë	kalë	benzinë	makinë
biçikletë	zile	makina e policisë	sirenë
banane	frutë	karotë	perime